



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E martë, 7 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Kuvendit nr. 14/2017, datë 6.3.2017	Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit.....	2743
Dekret i Presidentit nr.10039, datë 27.2.2017	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	2743
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 22, datë 15.2.2017	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017.....	2744
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 15.2.2017	Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike.....	2745
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 24, datë 15.2.2017	Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike.....	2755
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 25, datë 15.2.2017	Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr.169 datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103 datë 23.6.2016 “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.....	2768
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 15.2.2017	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë.....	2769

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 15.2.2017	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e programit të përputhshmërisë rregullatore.....	2769
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 28 datë 15.2.2017	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë Komp Energji” sh.p.k., me numër. 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.94, datë 6.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe“Hurdhas 3”.....	2769
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29 datë 15.2.2017	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k., me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr.102, datë 7.11.2014, për tregtimin e energjisë elektrike.....	2770
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 20.2.2017	Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a. për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.....	2771
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 20.2.2017	Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.....	2772
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 3, datë 3.2.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Kanalizime Patos.....	2773
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 4, datë 3.2.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 26, datë 20.5.2016 “Për licencim sh. a. Ujësjetës Kanalizime Elbasan”.....	2773
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 5, datë 3.2.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Kanalizime Pogradec.....	2773
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 6, datë 3.2.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Kanalizime Gjirokastër.....	2774
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 7, datë 3.2.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Poliçan.....	2774
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Rita Murati.....	2774



VENDIM
Nr. 14/2017

**PËR KTHIMIN E DOSJEVE TË
KANDIDATËVE QË KANË SHPREHUR
INTERESIN PËR TË KANDIDUAR PËR
INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT
TEK AVOKATI I POPULLIT PËR
RIPLOTËSIM TË DOKUMENTACIONIT
DHE RIHAPJEN E THIRRJES PËR
PARAQITJEN E SHPREHJES SË
INTERESIT NGA APLIKANTË TË RINJ
PËR POZICIONET E TË GJITHË
ANËTARËVE TË INSTITUCIONEVE TË
RIVLERËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, të neneve 62, 71, 141 dhe 144, të Kodit të Procedurave Administrative, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të kthejë dosjet e depozituara në Kuvend të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit, tek Avokati i Popullit. Avokati i Popullit njofton kandidatët që nuk kanë plotësuar kriteret formale për riplotësimin e dokumentacionit. Kandidatët, brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të dosjeve pranë këtij institucioni, paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për riplotësim të dokumentacionit përkatës, sipas neneve 6 dhe 7, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

II. Avokati i Popullit, brenda datës së njoftimit publik për plotësimin e dokumentacionit, sipas pikës I, të këtij vendimi, bën rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj, për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 6 dhe 7, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. Avokati i Popullit, sipas pikave I dhe II, të këtij vendimi, për vlerësimin e kandidatëve, ndjek procedurat dhe afatet procedurale të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. Kuvendi pezullon procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deri në ridërgimin e listave nga Avokati i Popullit, sipas këtij ligji.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 6.3.2017

DEKRET
Nr.10039, datë 27.2.2017

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Pullumb Selim Shtishi
2. Rado Simon Vuçiq (Nika)
3. Stojan Marko Šunjević (Pranvera)
4. Gëzim Kujtim Muharemi
5. Eriola Riza Prega
6. Suela Daut Andernach (Hysa)
7. Jurgen Trajko Krstović (Nikollaj)
8. Arjeta Sami Canja
9. Armando Kolë Shytani
10. Blerim Laver Hyseni
11. Patricia Besnik Aliaj
12. Ilir Sulejman Kola
13. Albana Musa Kola (Qoli)
14. Henri Ilir Kola
15. Aldi Shkëlqim Alimuçaj
16. Shqipe Haki Schröder (Shala)



17. Edmond Hasan Meta
18. Fellenxa Tefik Tusha (Shira)
19. Dejan Zharko Sekulić
20. Armand Dhimitër Shegaj
21. Besforta Halil Furriku
22. Marjana Sllabodan Vuçiq (Belja)
23. Shkëlqim Xhavit Kalaja
24. Patrick Fari Xhediku
25. Fabio Besnik Hani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 22, datë 15.2.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR
SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI DHE
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL PËR PERIU DHËN
KOHORE 1.1.2017 – 31.12.2017**

Në mbështetje të neneve 16, 20 germa “h” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 5 të VKM-së nr. 244 datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit

universal, OSHEE sh.a., për periudhën kohore 1 janar 2017 – 31 dhjetor 2017,

konstatoi:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244 datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.”

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën me nr. 31125 prot., datë 23.12.2016, ka përcjellë në ERE për dijëni draftkontratën për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017.

- Shoqëria KESH sh.a. me shkresën nr. 88 prot., datë 9.1.2017 ka përcjellë në ERE për dijëni draftkontratën për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017.

- Në ERE ka mbërritur edhe shkresa me nr. 1517 prot., datë 18.1.2017 e shoqërisë OSHEE sh.a. e cila bën me dije se nuk është dakord me nënshkrimin e draftit të dërguar nga shoqëria KESH sh.a. të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017–31.12.2017.

- Palët kanë një sërë mosdakordësish në lidhje me termat dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a.

- ERE me herët ka miratuar me vendimin nr.144, datë 25.8.2016, kontratën e sipërcituar për periudhën 1 korrik 2016 - 31 dhjetor 2016.

- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për furnizimin me energji elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal në përputhje me sa referuar më sipër, është e rregulluar.



- Çështjet për të cilat nuk kanë gjetur dakordësinë palët në procesin e negocimit të kësaj marrëdhënieje, duhet të jenë objekt i diskutimit me palët në kuadër të procedurave që ERE do të zhvillojë deri në finalizimin e kontratës për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2017.

- ERE duke konstatuar mosdakordësinë e palëve me njëri-tjetrin mbi draftin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2017–31.12.2017, me iniciativën e vet, propozon fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e draft kontratës së miratuar më herët me vendimin e bordit të ERE nr. 144, datë 25.8.2016.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., sipas draftit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.8.2016, për periudhën njëvjeçare, 1.1.2017 – 31.12.2017.

2. Shtyrjen e afatit të vendosur në kontratën e miratuar nga ERE me vendimin e bordit të ERE nr. 144, datë 25.8.2016, deri në miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për periudhën njëvjeçare, 1.1.2017– 31.12.2017.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a. KESH sh.a., dhe MEI për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 23, datë 15.2.2017

MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OST SHA DHE FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit,

ERE, me vendimin nr. 126, datë 29.7.2016 ka filluar procedurat për shqyrtimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, dhe ka realizuar procesin e konsultimit me palët e treta në përputhje me legjislacionin në fuqi,

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



KONTRATË E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT

ndërmjet

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA
(OST SHA)

dhe

FURNIZUESIT _____(F)

Kjo kontratë për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike lidhet sot më datë ___/___/___ midis:

Operatori i Sistemit të Transmetimit (më poshtë referuar si OST sh.a.), shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31935, datë 14.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me NIPT nr. K42101801N, përfaqësuar nga z. Engjëll Zeqo, administratori i shoqërisë, këtu e më poshtë referuar si OST,

dhe

_____ (F), regjistruar si person juridik pranë QKR në datën _____ me seli në _____ me adresë: _____ Shqipëri me NIPT nr. _____, përfaqësuar nga z., administrator i shoqërisë, këtu e më poshtë referuar si _____(F)

secila referuar sipas kontratës gjithashtu si “Pala” ose së bashku “Palët” sipas rastit.

Baza ligjore

- a) Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”;
- b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016 “Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike”;
- c) Vendimi i bordit të ERE-s “Për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”;
- d) Kodi i Rrjetit të Transmetimit;
- e) Vendimi nr. 24, datë 26.3.2009 i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike shoqërisë OST sh.a.”;
- f) Vendimi i bordit të ERE-s, nr. ___ datë ___/___/_____ “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 201__”
- g) Vendimi nr., datë ___/___/_____ i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencës si furnizues i shoqërisë _____;

ANEKS 1

Neni 1

Përkufizime

Në këtë kontratë, përfshirë dhe anekset e saj, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet si vijon:

“Kontratë” do të thotë kjo kontratë për shërbimin e transmetimit, së bashku me anekset, skedulet dhe dokumentacionin tjetër bashkëlidhur.

“Data e fillimit” do të thotë dita nga e cila kontrata fillon të shtrijë efektet e saj.

Palët do të thotë OST sh.a. dhe _____ (F).

OST sh.a. është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkuftare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

“(F)-Furnizuesi” është personi juridik i licencuar nga ERE, si furnizues, i cili ka lidhur kontratë të furnizimit me energji elektrike, me klientët fundorë, këtu e më poshtë referuar si _____F.

“Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak. Këtu e më poshtë referuar si KF.



“Pikat e matjes” janë pikat e lidhjes së aparateve matëse nëpërmjet të cilave bëhet e mundur matja e energjisë elektrike që kalon në atë element sipas aneksit 5 të kësaj kontrate.

“Disbalanca” është diferenca ndërmjet energjisë me bazë orare të nominuar nga F dhe energjisë së matur në pikën (pikat) e matjes të KF respektiv, siç përcaktuar edhe në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike (i ndryshuar).

“Sistem matës” është tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e matjes, mbrojtësit e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kablore të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në pikën e matjes.

“Program” do të thotë sasia orare e energjisë elektrike që nominohet nga F për furnizimin e KF të tij, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

“Transmetimi” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë dhe shumë të lartë, funksioni i të cilit përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

“Sistem i transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur paralel me sistemet e vendeve të tjera që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për livrimin e energjisë elektrike tek klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

“Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

“Përfaqësues i autorizuar” është personi i ngarkuar zyrtarisht nga titullari i kompanisë për ndjekjen e kësaj kontrate dhe nënshkrimin e deklaratës së matjes.

Çdo term tjetër i përdorur në këtë kontratë që nuk është përkufizuar këtu më lartë ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s.

Neni 2

Objekti i kontratës

2.1 Objekti i kontratës (Marrëveshja) është sigurimi i shërbimit të transmetimit për _____ (F) duke transmetuar nga pikat e marrjes deri në pikat e dhënies, sasinë e energjisë elektrike që _____(F) kërkon të transmetojë, për secilin prej klientëve të evidentuar në aneksin 2 dhe 5, si dhe rregullimi i marrëdhënieve financiare dhe pagesat midis palëve. Transmetimi i energjisë elektrike, në zbatim të kësaj kontrate do të fillojë në datën e fillimit të parashikuar në nenin 16.

2.2 Sasia e energjisë elektrike dhe periudhat kohore gjatë së cilës do të sigurohet shërbimi i transmetimit nga OST-ja, do të bëhet sipas kushteve të përcaktuara në aneksin 3 të kësaj kontrate.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e OST sh.a.

3.1 OST sh.a. do të sigurojë shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për _____(F), në sasinë dhe për periudhën kohore të specifikuar në aneksin 2 të kësaj kontrate, me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose rastet e një ndërprerjeje të paplanifikuar dhe të planifikuar (sipas përcaktimeve të bëra në nenet 9, 10 dhe 11 të kësaj kontrate).

3.2 OST sh.a. do të sigurojë këtë shërbim në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016 “Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike”, “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike” dhe “Kodin e Rrjetit të Transmetimit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s.

3.3 OST sh.a. ka të drejtë të faturojë dhe të arkëtojë vlerën e shërbimit të kryer në përputhje me këtë kontratë.



3.4 OST ka të drejtë të reduktojë programin e transmetimit (të furnizimit) për një periudhë të caktuar kohe, duke dhënë dhe shpjegimet përkatëse për këtë reduktim, sipas neneve 9 dhe 10 të kësaj kontrate.

3.5 OST ka të drejtë të ndërpresë shërbimin në përputhje me nenet 9, 10 dhe 11 të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e (f)

4.1 _____(F) do të informojë OST-së për sasinë e energjisë elektrike, nominimin me bazë orare, me numra të plotë në MW, të energjisë që do të transmetohet për llogari të _____ (F) nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për ditën në avancë, jo më vonë se ora 14.00 të çdo dite (në ditën D, për ditën D+1). Për ditët e fundjavës ose të festave, programi do të jepet në avancë, në ditën e fundit të punës dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e parë të punës pas pushimit. Programi (nominimi) i deklaruar nga _____ (F) paraqet një tabelë sipas aneksit 2, ku për çdo orë të ditës në avancë, jepet energjia (fuqia, kapaciteti në MW) që parashikohet të furnizohet dhe tërhiqet (konsumohet) në të gjitha pikat e matjes sipas aneksit 5. _____ (F) ka të drejtë të bëjë ndryshimin e skedulimit ditor, në çdo kohë, me kushtin që version i ri i skedulimit (nominimit) të jetë harmonizuar më parë me kaunterpartin përkatës (në anën tjetër të kufirit në rastin e importit, ose me centralin furnizues përkatës brenda vendit) dhe të deklarohet në OST, jo më vonë se dy orë para bërjes efektive të ndryshimit.

4.2 _____(F) do të përfitojë shërbimin e siguruar nga OST sh.a. në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë kontratë dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s.

4.3 _____(F) merr përsipër t'i paguajë OST-së për sa është parashikuar në nenin 2.1, çmimin e parashikuar sipas nenit 6.7 dhe të përgjigjet për disbalancat në përputhje me nenin 7 të kësaj kontrate.

Neni 5

Planifikimi i kërkesës

5.1 Planifikimi i kërkesës për energji elektrike do të bëhet sipas detyrimeve që kanë palët, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, miratuar me vendim të bordit të ERE, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të bordit të ERE-s dhe Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016 “Modeli i Tregut të energjisë elektrike”. Përgjegjës për parashikimin e ngarkesës që pritet të konsumohet nga KF përkatës, përkundrejt OST, është vetëm _____(F) që bën nominimin, dhe jo KF.

Neni 6

Sasia e transmetuar, çmimi, faturimi dhe pagesa

6.1 Parashikimet e këtij neni janë të zbatueshme për secilin prej klientëve fundorë që furnizohen nga _____ (F) dhe për secilën prej faturave që do të bëjë OST, në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të transmetuara për llogari të _____(F), me qëllim furnizimin e secilit prej klientëve apo grup klientësh.

OST bën një faturë mujore për çdo F pavarësisht nga numri i KF që ai furnizon.

6.2 OST do të masë sasinë e energjisë së transmetuar për javën paraardhëse, me bazë orare, për llogari të _____(F), në pikat e matjes të dhëna në aneksin 5 dhe do të informojë _____(F) me shkrim (Deklarimi/et) e matjes nga OST) mbi sasinë e sipërpërmendur, të detajuar për çdo klient të kualifikuar (sipas përcaktimeve të aneksit 4), jo më vonë se ora 12.00 çdo të mërkurë të javës së ardhshme të transmetimit.

6.3 Brenda 3 (tre) ditëve të para të punës, të çdo muaji kalendarik, OST-ja do të informojë _____(F) me shkrim (me shkëmbimin midis tyre të dokumenteve origjinale në rrugë zyrtare), mbi sasinë totale të energjisë elektrike të transmetuar, gjatë muajit paraardhës dhe të matur në pikat e matjes.

6.4 _____ (F) do të japë konfirmimin e tij ose do të bëjë ankesë në lidhje me saktësinë e të dhënave me shkrim ose *fax* ose *e-mail*, brenda 2 (dy) ditëve të para të punës nga dita e marrjes së njoftimit nga OST-ja. Pas këtij afati konfirmimi do të quhet i mirëqenë.



6.5 Nëse OST sh.a. e konsideron të justifikuar ankesën do të nxjerrë një raport të ri mujor të cilën ia përcjell _____ (F). Në rast se OST-ja e konsideron pretendimin si të pajustificuar njofton _____ (F) dhe nxjerr faturën tatimore mujore të shërbimit të transmetimit (këtu e më poshtë “Fatura”). Fatura do t’i dërgohet _____(F) në origjinal. Fatura, do të paraqesë sasinë e energjisë elektrike të transmetuar nga OST në muajin paraardhës, të matur në pikat e matjes si dhe mund të shprehë por pa u kufizuar të gjitha tarifatat, interesat, pagesat, rimbursimet, dëmet, dhe pagesa të tjera të zbatueshme dhe të detyrueshme për pagesë nga _____(F) sipas akt normativës në fuqi në RSH.

6.6 OST-ja do të dorëzojë faturën për shërbimin e kryer sipas nenit 2.1 të muajit paraardhës brenda datës 10 të muajit kalendarik pasardhës. Në rast se data 10 e muajit pasardhës, përkon me një ditë pushimi ose festë zyrtare, dorëzimi bëhet ditën e parë të punës që pason ditën/ditët e pushimit ose festës zyrtare.

6.7 _____(F) do të shlyejë tërësisht faturën brenda 10 ditëve pune nga data e lëshimit të faturës nga OST sh.a.

6.8 Në qoftë se _____(F) do të kontestojë një informacion si ai i përcaktuar në pikën 6.4 të kësaj Kontrate, atëherë _____(F) duhet t’i paraqesë OST-së, brenda 2 (dy) ditëve pune nga momenti i marrjes së këtij informacioni në rrugë zyrtare, një shpjegim me shkrim në lidhje me arsyet e kontestimit. OST nga ana e saj brenda 2 (dy) ditëve pune të ardhshme duhet të njoftojë me shkrim _____(F) për qëndrimin e saj në lidhje me këtë kontestim.

6.9 Në qoftë se _____(F) kundërshton në mënyrë të drejtë shumën e një fature të lëshuar nga OST-ja, shuma e padebatueshme do të paguhet në çdo rast në datën e duhur. Kundërshtime në mënyrë të drejtë do të konsiderohen vetëm ato që bëhen për gabimet që rezultojnë nga veprimet e OST sh.a.

6.10 Mbi pagesat e pakryera për shkak të pretendimeve të pabazuara, ose pagesat (tepricat) në faturë që tejkalojnë detyrimin real, do të aplikohet një interes prej 0.5% në ditë për çdo ditë vonese, që do të përllogaritet si më poshtë:

a) Në rastin e mospagesës, interesi do të përllogaritet nga data në të cilën duhet të ishte realizuar pagesa deri në datën që efektivisht realizohet pagesa.

b) Në rastin e mbipagesës, interesi do të përllogaritet nga data në të cilën është realizuar pagesa deri në datën që efektivisht realizohet kthimi i vlerës tepër të paguar.

6.11 Pagesa e faturave do të bëhet me transfertë bankare në numrat e llogarive bankare të OST sh.a.si më poshtë:

.....Bank: IBAN:.....

.....Bank: IBAN:.....

.....Bank: IBAN:.....

.....Bank: IBAN:.....

6.12 Në rast kur _____ (F) nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST-së, pagesat e pakryera grumbullojnë, një interes prej 0.5 % në ditë, për çdo ditë vonese, deri në datën e kryerjes së pagesës.

6.13 Në rast se _____(F) dështon në pagesat e faturave të energjisë elektrike deri në dy muaj pas datës së parashikuar në pikën 6.7, OST sh.a. ka të drejtë të mbajë vlerën e faturës së bashku me normën e interesit të grumbulluar, nga garancia financiare e depozituar nga _____(F) për regjistrim në tregun e energjisë elektrike konform rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike të miratuara nga bordi i ERE-s.

6.14 Çdo vendimmarrje e ERE-s në lidhje me çmime/apo tarifa të përcaktuara në këtë kontratë tip do të aplikohet automatikisht.

Neni 7

Disbalancat

7.1 Trajtimi dhe llogaritja e disbalancave të _____(F) do të kryhen sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të bordit të ERE-s. Çdo ndryshim i rregullave të tregut në lidhje me çështjen e balancimit do të hyjë automatikisht në fuqi.



Neni 8

Konfidencialiteti

8.1 Palët bien dakord që, për sa është e mundur, me përjashtim të rasteve kur kërkohet nga aktet normative në fuqi (duke përfshirë edhe rregullat e nxjerra nga çdo autoritet rregullator me juridiksion mbi Palën), kontratat e paraqitura nga palët, së bashku me çdo dokument ose të dhënë të transmetuar një Palë ndaj të tjerave, janë dhe duhet të mbeten konfidenciale. Gjithashtu, asnjë Palë nuk duhet t'ju komunikojë të tretëve (përveç auditëve ose këshilltarëve të saj financiarë ose ligjorë, bankës korrespondente ose çdo organi qeveritar me juridiksion mbi Palën), asnjë nga parashikimet e kësaj Kontrate apo detaje të çdo kontrate të paraqitur këtu, pa aprovimin paraprak me shkrim të Palës tjetër. Në qoftë se informacioni duhet të jepet, Pala së cilës i kërkohet informacioni duhet të njoftojë Palën tjetër dhe të marrë masa të arsyeshme për të kërkuar mbrojtjen e informacionit të kërkuar nga të tjera kërkesa.

8.2 Parashikimet e bëra në paragrafin 8.1 ngelen në fuqi për 5 vjet nga data e përfundimit të kontratës.

Neni 9

Forca madhore

9.1 Raste të forcës madhore

Me përjashtim të rasteve shprehimisht të parashikuara në këtë kontratë, asnjë Palë nuk do të konsiderohet në shkelje të kushteve të kësaj kontrate në qoftë se provon që moszbatimi i detyrimeve të tyre është i shkaktuar nga një rast force madhore. Për efekt të kësaj kontrate një rast “Force madhore” është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të të licencuarit dhe nuk ndodhin për faj të tij dhe i licencuari nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij.

9.2 Reagimi ndaj një rasti të force madhore

Çdo Palë do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme që të mënjanojë, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, arsyen e çdo vonese ose ndërprerje në zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të limituar dëmet e Palës tjetër. Në qoftë se një Palë merr njohuri për një rast force madhore që do të ndikojë apo mund të ndikojë mbi disa ose të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj kontrate, detyrohet të njoftojë menjëherë me shkrim Palën tjetër për situatën. Për të fituar kohë, ky komunikim mund të bëhet edhe në rrugë telefonike, por duhet të ndiqet edhe nga një komunikim i menjëhershëm me shkrim. Në të njëjtën mënyrë duhet vepruar edhe në rastet kur ndodh pushimi/mbarimi i rastit të forcës madhore.

9.3 Vazhdimi i kryerjes së detyrimeve

Në rast force madhore, palët do të ndërmarrin përpjekjet e tyre më të mira në mënyrë që të:

i) Vazhdojnë të kryejnë detyrimet sipas kësaj kontrate për sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, duke dhënë informacione të sakta ditore mbi sasinë e energjisë elektrike që është e mundur të transmetohet, në varësi të rrethanave.

ii) Minimizojë pasojat në lidhje me rastin e forcës madhore.

Neni 10

Ndërprerje të paplanifikuara

10.1 Nëse do të ndodhë një prej ngjarjeve të mëposhtme, OST sh.a. ka të drejtën të ndërpresë transmetimin e energjisë elektrike, për sa kohë që vazhdon ngjarja e ndërprerjes. Ngjarje të tilla janë:

(i) Prishje e pajisjeve, si edhe linjave të transmetimit të OST-së dhe të linjave të transmetimit të interkoneksionit, të cilat nuk mund të parashikoheshin ose riparoheshin.



(ii) Kur OST sh.a. është e detyruar të realizojë kufizime në transmetimin e energjisë elektrike me qëllimin e sigurisë në punë të sistemit elektroenergjetik, sipas përcaktimeve të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me vendim të Bordit të ERE.

10.2 OST do të bëjë përpjekjet më të mira të mundshme në mënyrë që të përfundojë sa më shpejt kryerjen e punimeve dhe minimizojë shqetësim/problemet për _____(F). OST-ja me anë të një akti teknik do të njoftojë zyrtarisht _____(F) në lidhje me ngjarjen e ndërprerjes.

Neni 11

Ndërprerje të planifikuara

11.1 Procesi i ndërprerjeve të planifikuara do të bëhet konform rregullave të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, miratuar me vendim të ERE-s.

11.2 Në mënyrë që të lejohet _____(F) të marrë masat e përshtatshme, OST, në përputhje me programin vjetor të remonteve, të rakorduara mes palëve, do të informojë me shkrim _____(F) jo më vonë se 20 ditë para fillimit të punimeve të mirëmbajtjes, duke specifikuar zgjatjen e punimeve dhe objektin (vendin) ku do të kryhen këto punime. Pas këtij njoftimi OST i lind e drejta të fillojë punimet e mirëmbajtjes pa pasur nevojën për një aprovim paraprak nga ana e _____(F). Në rast se _____(F) ka shkaqe të arsyeshme për të kërkuar mosndërprerjen e energjisë elektrike, njofton OST-në brenda tre ditë pune nga marrja e njoftimit për remontin.

OST vlerëson kërkesën e _____(F) dhe kthen përgjigje mbi pranimin ose jo të kërkesës, ditën e nesërme të marrjes së saj.

11.3 OST detyrohet të përfundojë kryerjen e punimeve brenda afatit të njoftuar.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ligjet e zbatueshme

12.1 Kjo kontratë do të zbatohet në përputhje me aktet normative dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

12.2 Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate, mosmarrëveshja do t'i njoftohet Përfaqësuesve të autorizuar për trajtimin e mosmarrëveshjes të çdo Palë, të cilët do të tentojnë me mirëbesim ta zgjidhin atë sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se Përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'u njoftohet Palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për ato. Në qoftë se Përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm, ose në qoftë se një Palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë çështja do të zgjidhet nga ERE sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike, Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit.

12.3 Kur mosmarrëveshjet e palëve i referohen interpretimit të Kodit të Rrjetit palët do të veprojnë në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjetit, si dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe vendimi i ERE-s është i detyrueshëm për zbatim nga palët.

12.4 Secila prej palëve ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në rast se nuk është dakord me zgjidhjen e dhënë sipas pikës 12.2.

Neni 13

Kundërvajtjet administrative

13.1 Në rast se furnizuesi shkel një prej kushteve të kësaj kontrate, apo legjislacionin që rregullon sektorin e energjisë elektrike në fuqi, OST sh.a. ka të drejtë të dërgojë një kërkesë të argumentuar për marrjen e masave nga ana e ERE, sipas nenit 42 dhe/apo nenit 107 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.



Neni 14
Autorizimet

14.1 Palët pohojnë dhe garantojnë se kanë marrë të gjitha autorizimet e nevojshme dhe licencat e kërkuara për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj kontrate.

Neni 15
Njoftimet, përfaqësuesit e autorizuar etj.

15.1 Menjëherë pas firmosjes së kësaj kontrate, çdo palë do të përcaktojë me shkrim një Përfaqësues të autorizuar (Përfaqësuesi i autorizuar) që do të jetë i autorizuar të nënshkruajë deklaratën e matjes.

15.2 Njoftimet, faturat (që parashikohen në nenin 6.3, 6.4, 6.5 dhe 6.8 më lart) ose dokumente të tjerë në lidhje me këtë kontratë do të dërgohen me faks në numrat e përcaktuar më poshtë dhe do të konsiderohen të marra kur aparati që ka dërguar faksin do të ketë konfirmuar transmetimin. Çdo Palë mund të ndryshojë numrin e saj të faksit duke njoftuar me shkrim Palën tjetër. Në rast se njëra palë ka ndryshuar numrin e faksit, pa njoftuar më parë palën tjetër, çdo njoftim i dërguar nga pala tek numri i mëparshëm do të konsiderohet i marrë prej palës që ka bërë ndryshimin dhe nuk ka njoftuar.

15.3 Palët bien dakord që t'i njoftojnë strukturat e tyre përkatëse për lidhjen e kësaj kontrate dhe t'i udhëzojnë ato për detyrimet që rrjedhin prej saj me qëllim marrjen e të gjitha masave për zbatimin e saj.

15.4 Për çdo ndryshim në përcaktimet e bëra në këtë nen, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën brenda 24 orësh.

Personat e autorizuar për të dy palët do të jenë:

Për OST: z. Pozicioni:

OST sh.a.

Autotrada Tiranë- Durrës

Km 9, Yrshek

Kashar, Tiranë

tel: +355 4 2225581 fax: + 355 4 2225581

Për (F): z.

Pozicioni:

Administrator i _____(F)

Rruga: nr:

tel:

fax:

email:

Neni 16
Afati i zbatimit të kontratës

16.1 Kjo kontratë ka afat deri në datëndhe i shtrin efektet që nga data e fillimit të zbatimit të kontratës të lidhur midis _____(F) dhe çdo klienti fundor, referuar pikës 3 “Kohëzgjatja e kontratës” në aneksin 2.

16.2 _____(F) duhet të njoftojë menjëherë OST-në për përfundimin e kontratës me secilin prej klientëve fundorë dhe për ndërprerjen e shërbimit të transmetimit me qëllim furnizimin me energji elektrike të klientit fundor përkatës _____(F), duhet të njoftojë OST-në se ka lidhur kontratë të furnizimit me një klient të ri fundor, tre ditë para datës së furnizimit.

16.3 Kjo kontratë është e vlefshme dhe i shtrin efektet mes palëve edhe në rast se, gjatë kohës së zbatimit të saj, _____(F) njofton se ka ndërprerë kontratën e furnizimit me njërin prej klientëve fundorë ose ka lidhur kontratë të furnizimit me një klient të ri fundor. _____(F) do të njoftojë menjëherë OST-në dhe palët do të reflektojnë ndryshimet përkatëse në anekset e kësaj kontrate. Këto ndryshime nuk do të prekin asnjë prej kushteve të tjera të kësaj kontrate dhe nuk do t'i nënshtrohen miratimit të ERE të parashikuar në nenin 16.



Neni 17

Ndryshimet dhe amendimet

17.1 Çdo ndryshim i kësaj kontrate miratohet me vendim të bordit të ERE-s.

Neni 18

Ekzekutimi nga palët

18.1 Kjo kontratë hartohet në 3 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për OST dhe 1 për furnizuesin.

18.2 Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj kontrate bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.

Neni 19

Dispozita përfundimtare

19.1 Palët shprehimisht marrin përsipër dhe premtojnë që:

i) të ndërmarrin veprime të cilat janë të arsyeshme, me ndershmëri, qëndrueshmëri dhe është e rëndësishme të mbajnë vazhdimësinë e shërbimit dhe këtë kontratë në ekzistencë;

ii) të ndërmjetësojnë dhe ndryshojnë këtë kontratë nëse do të jetë e nevojshme si rrjedhojë e ndryshimeve në ligj ose akte nënligjore;

19.2 Të gjitha kontratat e nënshkruara deri më sot për shërbimet e transmetimit midis palëve shfuqizohen.

Tiranë, / /

Në emër dhe për llogari të OST sh.a.

Në emër dhe për llogari të _____(F)

Administrator

i OST sh.a.

Engjëll Zeqo

Administrator i _____ (F)

ANEKSI 1

Vendimi nr., datë i Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencës si Furnizues i shoqërisë”

ANEKSI 2

Formular njoftimi i kontratave të lidhura midis _____(F) dhe klientëve fundorë

Për klientin fundor:

1. Identifikimi i palëve të kontraktuara: _____(F) dhe (KF)

2. Pikat e livrimit/tërheqjes: Hyrja, n/stacioni

3. Kohëzgjatja e kontratës: -

4. Sasitë e kontraktuara dhe programet orare të zbatueshme: MWh

ANEKSI 3

Kushtet për transmetimin e energjisë

OST dhe _____(F) do të zbatojnë Rregullat e Tregut, Kodin e Sistemit të Transmetimit, Kodin e Matjes dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë.

OST do të transmetojë energjinë elektrike, sipas programeve të nominuara, në parametrat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe cilësisë së parametrave të kësaj energjie në pikat e marrjes së energjisë sipas specifikimeve dhe parametrave të dhëna në Kodin e Sistemit të Transmetimit.



OST do të aplikojë në faturën e detyrimeve të _____(F) për energjinë e transmetuar pagesat apo tarifat e miratuara nga ERE, të cilat miratohen dhe hyjnë në zbatim përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate.

_____(F) merr përsipër detyrimin për zbatimin e udhëzimeve dhe kërkesave të dhëna nga Operatori Dispeçer i OST, që kanë të bëjnë me dispeçerimin e Sistemit Elektroenergetik.

_____(F) merr përsipër të njoftojë jo më vonë se 10 ditë më parë OST-në për ndryshime të skemës në rrjetin e tij të shpërndarjes që kanë për pasojë ndryshime të konsiderueshme të kërkesës në një pikë/disa pika marrje të sistemit të transmetimit.

Tarifa e transmetimit, fiksuar në këtë kontratë, nuk ka lidhje me nivelin e tensionit të pikës së marrjes së energjisë apo karakteristikat e konsumatorit që furnizohet nga _____(F).

Palët në kontratë bien dakord se vlerësimi i cilësisë së furnizimit të energjisë elektrike, objekt i kësaj kontrate, është proces identifikimi, matje dhe arsyetimi në një akt të përbashkët të konfirmuar nga Palët.

ANEKSI 4

Matja, rakordimet, etj.

Matja e energjisë elektrike të transmetuar në sistemin e transmetimit nga OST, për llogari të _____(F) do të bëhet në pikën/pikat e përcaktuara në këtë kontratë.

Instalimi, administrimi, rinovimi, kontrolli dhe verifikimi i pajisjeve të matjes janë të rregulluara konform përcaktimeve të Kodit të Matjes.

Matja e energjisë elektrike do të bëhet nga OST, për çdo orë të ditës, nga ora 00.00 deri 24.00, me pajisjet, standardet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Matjes.

Faturimi i detyrimeve reciproke, ndërmjet palëve në kontratë, do të bëhet në fatura mujore mbi bazë të matjeve orare.

OST ka detyrimin për matjen dhe njoftimin e të dhënave nga sistemi i matjes, në përputhje me afatet dhe specifikimet e dhëna në Rregullat e Tregut.

OST do të ofrojë një informacion shtesë nga sistemi i matjes në përputhje me kërkesën e _____(F) për aq sa OST e vlerëson se nuk cenon interesat e palëve të tjera në treg dhe ecurinë normale të Tregut.

Rakordimi i të dhënave të matjes midis palëve është një detyrim që paraprin procesin dhe afatet e faturimit të detyrimeve mujore ndërmjet palëve dhe do të bëhet në afatet dhe sipas Rregullave të Tregut.

OST do të masë sasinë e energjisë së transmetuar të kontratës për javën paraardhëse për llogari të _____(F), në Pikat e matjes dhe do të informojë me shkrim _____(F) ("Deklarimi/(et) i/(e) matjes nga OST") mbi sasinë e sipërpërmendur (sipas përcaktimeve të Aneksit 2), jo më vonë se ora 12.00 çdo të mërkurë të javës së ardhshme të transmetimit.

OST do të masë sasinë e energjisë së transmetuar për llogari të _____(F) në të gjitha pikat e matjes në ditën paraardhëse në bazë orare dhe do të informojë me shkrim (e-mail) _____(F) mbi sasinë e sipërpërmendur jo më vonë se ora 12.00 e ditës pasardhëse. Për ditët e fundjavës ose të festave, ky informacion do të jepet në ditën e parë të punës pas ditës së pushimit dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e fundit të punës para pushimit. Sasia e matur nga OST-ja, paraqet një tabelë (*worksheet*), ku për çdo orë të ditës së mëparshme, jepet energjia e transmetuar në kWh në çdo pikë matje sipas aneksit 5.

Meqenëse sistemi i telematjes, për shkak të teknologjisë, mund të ballafaqohet me dështime të transmetimit të të dhënave nga matësi në serverin e qendrës së matjes, por jo dështime të regjistrimit të të dhënave në memorien e vetë matësit, dështime këto që janë mjaft të rralla dhe të shkurtra në kohë, dhe që njoftohen, sinjalizohen automatikisht nga vetë sistemi i matjes, atëherë të dhënat orare/ditore që do të komunikohen nga operatori i matjes/tregut, kur shoqërohen me shënimin e prezencës së dështimeve të pjesshme në pikën e matjes përkatëse, duhet të konsiderohen si të dhëna operative (jo përfundimtare, të vlefshme për faturim) që i shërbejnë çdo pjesëmarrësi të tregut për të vlerësuar pozicionin e tij, në lidhje me realizimin e nominimit të deklaruar apo disbalancave përkatëse. Të dhënat (matjet) e patransmetuara të ruajtura në memorien e matësit përkatës, do të tërhiqen me ndërhyrje



manuale në një kohë të mëvonshme (jo brenda ditës) dhe do të transmetohen në serverin përkatës në qendër duke ruajtur identitetin e tyre, (orën përkatëse), duke bërë të mundur azhurnimin e tabelës orare të matjeve, e vlefshme për njoftimet (deklarimet) me bazë javore, por në mënyrë finale me bazë mujore. Këto të dhëna me bazë orare (të azhurnuara në rastet e shfaqjes së dështimeve) do të shërbejnë si bazë për llogaritjen e disbalancave, bilancit energjetik, faturimit etj.

Kur në sistemin e matjes, nuk janë transmetuar të dhënat përkatëse, për shkak të defektit ose rënies së matësit për kërkesën, OST për qëllimet e likuidimit do të vlerësojë sasinë e transmetuar të energjisë elektrike, bazuar në të dhënat historike dhe në të dhënat e mekanizmave të tjerë matës gjatë periudhës përkatëse.

ANEKSI 5 Pikat e Matjes

Emri i klientit fundor	Emri i n/stacionit	Kodi i pikës së matjes në sistemin e OST-së

VENDIM Nr. 24, datë 15.2.2017

MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SH.A. DHE FURNIZUESIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 139, datë 15.8.2017, i ndryshuar; VKM-ja nr. 519, datë 13.7.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s “Për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- ERE, me vendimin nr. 11, datë 14.10.2016, ka filluar procedurat për shqyrtimin e

marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike dhe ka realizuar procesin e konsultimit me palët e treta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Furnizuesi

Nr _____ Prot

Tiranë, ___ / ___ /

Marrëveshje për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Ndërmjet

Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Shqipëri (OSHEE) dhe (Furnizuesit)

Kjo Marrëveshje për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike lidhet sot më datë ___ / ___ / ___ midis:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Shqipëri, (OSHEE sh.a.) shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me vendimin _____ Tiranë, Shqipëri, me NUIS _____, përfaqësuar nga z. _____, administratori i shoqërisë (këtu e më poshtë referuar si OSHEE),

dhe

[_____] Furnizuesit (F), regjistruar si person juridik pranë QKR-së në datën _____ me seli në Shqipëri, me adresë _____, përfaqësuar nga _____, person i autorizuar i shoqërisë, këtu e më poshtë referuar si Furnizuesi (F),

Secila nga palët në këtë Marrëveshje, OSHEE edhe Furnizuesi, iu jemi referuar si “Pala” ose së bashku “Palët” sipas rastit.

A. Përshkrimi

OSHEE është licencuar në aktivitetin e shpërndarjes.

B. OSHEE ka rënë dakord që të sigurojë shërbimet e shpërndarjes dhe të kryejë detyrimet e tjera sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

C. Furnizuesi bie dakord të paguajë OSHEE-në për shërbimet e shpërndarjes dhe të kryejë detyrimet e tjera të tij sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

D. OSHEE dhe Furnizuesi pranojnë se, përveç kësaj Marrëveshje ato të dyja janë subjekt i respektimit të parashikimeve të Kodet.

Baza ligjore dhe përputhshmëria me ligjin për sektorin e energjisë elektrike

I- Baza ligjore

a) Ligji nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”;

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Sektorit të Energjisë Elektrike”, në fuqi.

c) Vendimi i bordit të ERE-s “Për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, në fuqi.

ç) Vendimi i bordit të ERE-s “Për miratimin e Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”,

d) Vendimi i bordit të ERE-s nr. ___ datë ___ . ___ . ___ “Për dhënien e licencës si furnizues shoqërisë _____”; Aneks 1

dh) Vendimi i bordit të ERE-s _____ “Për licencimin e shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”, në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”; aneks 1

II- Përputhshmëria me ligjin për sektorin e energjisë elektrike

a) Detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” prevalojnë mbi të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, në rast mospërputhje mes tyre.

b) Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje, secila Palë duhet të përmbushë detyrimet e vendosura për atë Palë nga ligji “Për sektorin e energjisë elektrike”.

c) Secila Palë në mënyrë që t’i lejojë Palës tjetër që të plotësojë detyrimet e vendosura në këtë Marrëveshje duhet:

(1) t’i japë Palës tjetër të gjithë ndihmën;

(2) të bashkëpunojë me Palën tjetër.



d) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të kufizojë ndonjë të drejtë që Palët mund të gëzojnë nga ligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, përveç rasteve kur ky ligj e lejon që kjo e drejtë të kufizohet nga Marrëveshja.

dh) Për qëllim të kësaj Marrëveshje, asnjëra Palë nuk do të konsiderohet se ka shkelur parashikimet e ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, nëse ajo ka vepruar:

(1) sipas direktivave të ERE-s; ose

(2) në përputhje me termat ose ndonjë përjashtim nga përputhshmëria me ligjin, të dhënë me shkrim nga ERE.

MARRËVESHJA

Palët bien dakord si më poshtë, duke marrë në konsideratë dhe midis të tjerash premtimet e ndërsjella të përfshira në këtë Marrëveshje.

Neni 1

Përkufizime

Në këtë Marrëveshje, përfshirë dhe anekset e saj, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet sipas ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si vijon:

Marrëveshje	Kjo Marrëveshje për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, së bashku me anekset bashkëlidhur
Data e fillimit	Data nga e cila marrëveshja fillon të shtrijë efektet e saj.
Palët	OSHEE dhe/ose Furnizuesi
OSHEE	Personi juridik i licencuar nga ERE për të kryer veprimtarinë e Shpërndarjes dhe që është Palë e kësaj Marrëveshjeje.
(Furnizuesi) (F)	Personi juridik i licencuar nga ERE si Furnizues, i cili ka lidhur ose do të lidhë një kontratë ose kontrata për furnizimin me energji elektrike, të klientëve fundorë dhe që është Palë e kësaj Marrëveshjeje.
Klient Fundor (KF)	Një konsumator që blen energji elektrike për përdorimin e tij personal.
Pikat e matjes	Çdo pikë lidhjeje, përmes së cilës aparati matës bën të mundur matjen e energjisë elektrike në atë element sipas aneksit 2.
Sistem Matës	Është tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e matjes, mbrojtësit e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e shpërndarjes dhe komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllorë të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në pikën e matjes.
Konsumi	Do të thotë sasia orare/mujore e energjisë elektrike që konsumohet nga KF, dhe që i korrespondon grupit balancues të F.
Shërbimi i shpërndarjes	Është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.
Sistem i shpërndarjes	“Sistemi i shpërndarjes” është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.
Përfaqësues i autorizuar	Personi i ngarkuar zyrtarisht nga titullari i shoqërisë për ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje.
Kodet, rregullat dhe marrëveshjet	Kodi i Operimit të Shpërndarjes, Kodi i Rrjetit të Transmetimit, Kodi i Matjes, Rregullat e Tregut.
Ligji i sektorit të energjisë elektrike	Ligji shqiptar për sektorin e energjisë elektrike nr. 43/2015.
Forcë madhore	“Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij



	sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
Kontrata e furnizimit	Kontrata midis furnizuesit dhe konsumatorit fundor sipas të cilës furnizuesi bie dakord të furnizojë me energji elektrike konsumatorin fundor.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

2.1 Objekti i marrëveshjes (Marrëveshja) është sigurimi i Shërbimit të Shpërndarjes për _____ (F) duke shpërndarë nga pikat e marrjes deri në pikat e dhënies, sasinë e energjisë elektrike që _____ (F) kërkon të shpërndajë/konsumatorët e përfshirë në grupin e balancimit të (F) kërkojnë të konsumojnë, për secilin prej klientëve të evidentuar në aneksin 2, si dhe rregullimi i marrëdhënieve financiare dhe pagesat midis palëve. Shpërndarja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të fillojë në datën e fillimit të parashikuar në nenin 18.

2.2 Sasia e energjisë elektrike dhe periudhat kohore gjatë së cilës do të sigurohet shërbimi i shpërndarjes nga OSHEE, nga operatori i sistemit do të bëhet sipas kushteve të përcaktuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Shërbimet e shpërndarjes

3.1 Objekti i kësaj Marrëveshjeje është që shërbimet e shpërndarjes t'i sigurohen Furnizuesit nga OSHEE duke shpërndarë nga pikat e marrjes dhe dhënies sasinë e energjisë elektrike që furnizuesi i shtet konsumatorit fundor që është përfshirë në grupin e balancimit të furnizuesit, sipas kontratave të furnizimit, siç tregohet në aneksin 2.

3.2 Sasia e energjisë elektrike dhe afatet gjatë të cilave shërbimet e shpërndarjes duhet të sigurohen nga OSHEE, duhet të jenë sipas kushteve të specifikuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e OSHEE

4.1 OSHEE do të sigurojë shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për furnizuesin, në sasinë dhe për periudhën kohore të specifikuar në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose rasteve të një ndërprerjeje të paplanifikuar dhe të planifikuar (sipas përcaktimeve të bëra në nenet 10, 11 dhe 12 të kësaj Marrëveshjeje).

4.2 OSHEE do t'i sigurojë këto shërbime në përputhje me Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Kodin e Shpërndarjes dhe "Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shpërndarjes së energjisë elektrike".

4.3 OSHEE ka të drejtë të faturojë dhe arkëtojë vlerën e shërbimeve të shpërndarjes të kryer në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

4.4 OSHEE ka detyrimin që të ndërpresë shërbimin e shpërndarjes kundrejt KF të cilët nuk disponojnë një kontratë të vlefshme furnizimi, dhe duhet që në përputhje me afatet e parashikuara në 'Rregullore mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike' të përfundojë shërbimet e shpërndarjes për konsumatorin fundor sipas kërkesës së furnizuesit. Çdo detyrim që lind pas hyrjes në fuqi të zgjidhjes së kontratës së furnizimit të KF nga ana e _____(F), ngarkon me përgjegjësi të plotë OSHEE.

4.5 OSHEE do të sigurojë shërbimin e furnizimit për konsumatorin fundor, për aq sa ligji 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" ka parashikuar.



Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit

5.1 Furnizuesi do të informojë OST-OT për sasinë e energjisë elektrike, në përputhje me Rregullat e Tregut dhe aktet e tjera nënligjore.

5.2 Furnizuesi do të përfitojë shërbimin e shpërndarjes të siguar nga OSHEE në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Marrëveshje dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, në fuqi, dhe Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes.

5.3 Furnizuesi merr përsipër t'i paguajë OSHEE-së siç përshkruhet në këtë Marrëveshje çmimin e parashikuar në këtë kontratë. Në lidhje me disbalancat _____ (F) do t'i përgjigjet vetëm OST-OT.

5.4 Furnizuesi po ashtu ka detyrimet e mëposhtme:

- (a) të veprojë në përputhje me kodet, me rregullat dhe marrëveshjet;
- (b) të sigurojë informacion mbi konsumin; dhe
- (c) t'u përgjigjet kërkesave nga OSHEE për detaje të konsumatorit fundor të cilat mund t'i sigurojë për shkak të kontratës me të.

Neni 6

Planifikimi i kërkesës

6.1 Planifikimi i kërkesës për energji elektrike do të bëhet sipas detyrimeve që kanë palët, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

6.2 Përgjegjës për parashikimin e ngarkesës që pritet të konsumohet nga KF, është furnizuesi.

Neni 7

Sasia e transmetuar, çmimi, faturimi dhe pagesa

7.1 Brenda 4 (katër) ditëve të para të punës, të çdo muaji kalendarik, OST-OT do të informojë Furnizuesin me shkrim (me shkëmbimin midis tyre të dokumenteve origjinale në rrugë zyrtare), mbi sasinë totale të energjisë elektrike të konsumuar nga çdo KF, që është pjesë e grupit balancues të furnizuesit, gjatë muajit paraardhës dhe të matur në pikat e matjes.

7.2 Furnizuesi do të japë konfirmimin e tij ose do të bëjë ankesë në lidhje me saktësinë e të dhënave, me shkrim, *fax* dhe/ose *e-mail*, brenda 2 (dy) ditëve të para të punës nga dita e marrjes së njoftimit nga OST-OT. Pas këtij afati, konfirmimi do të quhet i mirëqenë.

7.3 Parashikimet e këtij neni janë të zbatueshme për secilin prej KF që furnizohen nga furnizuesi dhe për secilën prej faturave që do të bëjë OSHEE, në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të shpërndarë për llogari të furnizuesit, me qëllim furnizimin e secilit prej klientëve apo grup klientësh fundorë. OSHEE bën një faturë mujore për furnizuesin pavarësisht nga numri i KF që ai furnizon.

7.4 Nëse ka kontestim nga Furnizuesi dhe OST-OT e konsideron të justifikuar ankesën, do të nxjerrë një raport të ri mujor, të cilën ia përcjell furnizuesit faturën në formë elektronike menjëherë pas konfirmimit. Në rast se OST-OT e konsideron pretendimin si të pajustificuar, njofton furnizuesin. OSHEE lëshon faturën tatimore mujore të shërbimit të shpërndarjes (këtu e më poshtë "Fatura"). Fatura do t'i dërgohet Furnizuesit në origjinal. Fatura, do të paraqesë sasinë e energjisë elektrike të konsumuar nga KF, si pjesë e grupit balancues të furnizuesit në muajin paraardhës, të matur në pikat e matjes si dhe mund të shprehë por pa u kufizuar, të gjitha tarifrat, interesat, pagesat, rimbursimet, dhe pagesa të tjera të zbatueshme dhe të detyrueshme për pagesë nga furnizuesi sipas akteve normative në fuqi.

7.5 Faturat e lëshuara sipas nenit 7.4 duhet të jenë të formatit, të vendosur nga Pala e cila ka nxjerrë faturën, duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe duhet të përmbajnë informacion të mjaftueshëm pasi është e arsyeshme që t'i lejohet marrësit:

- (1) të ketë akses në saktësinë e detyrimeve të specifikuar në secilën faturë;



(2) të përputhet me ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” në lidhje me sigurimin e informacionit për klientët fundorë për këto detyrime.

7.6 Në rast kontestimi, furnizuesi do të paguajë shumën e padebatueshme në çdo rast, në datën e duhur përcaktuar në nenin 7.7. Për shumën e debatueshme Palët ndjekin procedurat e përcaktuara në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

7.7 OSHEE do të dorëzojë faturën për shërbimin e shpërndarjes të kryer gjatë muajit paraardhës brenda datës 10 të muajit kalendarik pasardhës. Në rast se data 10 e muajit pasardhës, përkon me një ditë pushimi ose festë zyrtare, dorëzimi bëhet ditën paraardhëse të ditës/ditëve të pushimit ose festës zyrtare. Data e faturës do të jetë në përputhje me aktet normative në fuqi. Furnizuesi do të shlyejë tërësisht faturën, jo më vonë se dita e fundit e muajit pasardhës nga data e lëshimit të faturës nga OSHEE.

7.8 Mbi pagesat e pakryera për shkak të pretendimeve të pabazuara, ose pagesat (tepricat) në faturë që tejkalojnë detyrimin real, si dhe në rastet kur furnizuesi nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OSHEE-së, do të aplikohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar.

7.9 Pagesa e faturave do të bëhet me transfertë bankare në numrat e llogarive bankare të OSHEE si më poshtë:

.....Bank: IBAN:

7.10 Çdo vendimmarrje e ERE në lidhje me tarifat, çmime apo detyrime të përcaktuara në këtë Marrëveshje (duke përfshirë çdo ngritje ose ulje të nivelit të këtyre tarifave) do të aplikohet automatikisht nga Palët dhe kjo Marrëveshje do të gjykohet rast pas rasti nëse do të ndryshohet.

7.11 Detyrimi i furnizuesit për të paguar tarifat/detyrimet e shërbimeve të shpërndarjes ndaj OSHEE nuk do të ndikohet nga vonesat ose dështimi i konsumatorit të fundit për të paguar furnizuesin në lidhje me shitjen e energjisë elektrike ose shërbimeve të shpërndarjes sipas kontratës së furnizimit.

7.12 Një tarifë/detyrim i pasaktë në faturë, dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të ndryshohet nga Pala e cila ka nxjerrë faturën, në faturën tjetër pas gjetjes së gabimit, për ta ndrequr atë. Shkaqet e gabimit mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga:

- (1) ndërhyrje në matës;
- (2) matës të dëmtuar, lexim i matësit të dëmtuar;
- (3) gabime nga Operatori i Sistemit në lidhje me detyrimet ndaj OSHEE;
- (4) gabime në konsumin e faturuar të energjisë elektrike të Konsumatorit Fundor;
- (5) ndryshimet midis leximeve të vlerësuara të matësit dhe të dhënat e matësit të marra pasi është lëshuar fatura;
- (6) shumat e vendosura ose rregulluara nga autoriteti rregullator.

7.13 Një faturë e rregulluar, lëshuar sipas nenit 7.12 duhet të përfshijë ose të shoqërohet nga një shpjegim pse është lëshuar fatura e rregulluar.

7.14 Në çdo rast, rregullimi i faturës duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës fiskal.

Neni 8

Kompensimi i furnizuesit

8.1 Në të gjitha rastet e ndërprerjeve, pavarësisht aplikimit të të drejtave të furnizuesit të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje, OSHEE do t'i paguajë Furnizuesit penalitetet automatike të përllogaritura në përputhje me dispozitat përkatëse të “Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

8.2 OSHEE është përgjegjës për dëmet që mund t'i shkaktohen furnizuesit për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e përcaktuara në aktet në fuqi, vetëm në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë, apo me faj të saj.

Përcaktimi i dëmit efektiv të shkakuar furnizuesit, bëhet me marrëveshje midis palëve, ose në rrugë gjyqësore.



8.3 Në të gjitha rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara, me përjashtim të ndërprerjeve të shkaktuara ose rezultatit të ekzistencës së Forcës Madhore, energjia e cila nominohet nga Furnizuesi por nuk shpërndahet nga OSHEE për shkak të ndërprerjes, do të kompensohet nga OSHEE si më poshtë vijon:

OSHEE do t'i paguajë furnizuesit diferencën pozitive ndërmjet çmimit të kontratës/kontratave (në varësi të të kohëzgjatjes të ndërprerjes që afekton secilën kontratë Furnizimi në mënyrë individuale) dhe çmimit të disbalancave pozitive të aplikuara nga OST.

8.4 OSHEE është e detyruar të paguajë penalitetet/dëmet e përlogaritura sipas përcaktimeve të këtij neni, brenda tre (3) ditëve pune pas marrjes së kërkesës dhe faturës për pagesën e këtyre dëmeve.

Neni 9

Konfidencialiteti

9.1 Palët bien dakord që, për sa është e mundur, me përjashtim të rasteve kur kërkohet nga aktet normative në fuqi (duke përfshirë edhe rregullat e miratuara nga ERE ose çdo autoritet rregullator me juridiksion mbi Palën), marrëveshjet e paraqitura nga Palët, së bashku me çdo dokument ose të dhënë të transmetuar nga një Palë ndaj të tjerave dhe i gjithë informacioni i shkëmbyer midis Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje ose gjatë negociemeve që paraprijnë datën e fillimit, janë dhe duhet të mbeten konfidenciale. Gjithashtu, asnjë Palë nuk duhet t'u komunikojë të tretëve (përveç auditëve ose këshilltarëve të saj financiarë ose ligjorë, bankës korrespondente ose çdo organi qeveritar me juridiksion mbi Palën), asnjë nga parashikimet e kësaj Marrëveshjeje apo detaje të çdo marrëveshjeje të paraqitur këtu, pa aprovimin paraprak me shkrim të Palës tjetër. Në qoftë se informacioni duhet të jepet, Pala së cilës i kërkohet informacioni duhet të njoftojë Palën tjetër dhe të marrë masa të arsyeshme për të kërkuar mbrojtjen e informacionit të kërkuar nga të tjera kërkesa.

9.2 Parashikimet e bëra në paragrafin 9.1 ngelen në fuqi për 5 vjet nga data e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Neni 9.1 nuk do të zbatohet në rastet e mëposhtme:

- a) vetëm me pëlqimin e Palës e cila është burim informacioni;
- b) nëse informacioni në çdo kohë është ligjërish në posedim të marrësit të propozuar të informacionit përmes burimeve dhe jo të ndonjë Pale tjetër;
- c) në shkallën e kërkuar nga ligji, Rregulli ose Marrëveshje ose nga një kërkesë e ligjshme e ERE ose ndonjë autoriteti rregullator i cili ka juridiksion mbi një Palë (ose sipas licencës që mban ajo Palë ose ndryshe);
- d) nëse kërkohet në lidhje me procedurat ligjore ose zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që kanë lidhje me këtë Marrëveshje ose për qëllim të këshillimit të Palës në lidhje me këto;
- e) nëse informacioni është në dispozicion në mënyrë të përgjithshme dhe publike dhe jo si rezultat i shkeljes së besimit nga ana e njëres Palë e cila dëshiron të shpërndajë informacionin ose ndaj një personi të cilit i është shpërndarë informacioni;
- f) nëse shpërndarja e informacionit është e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të shpërndarjes ose të mbrojtjes së sigurisë e personelit ose të pajisjeve.

Neni 10

Forca madhore

10.1 Raste të forcës madhore

Me përjashtim të rasteve shprehimisht të parashikuara në këtë Marrëveshje, asnjë Palë nuk do të konsiderohet në shkelje të kushteve të kësaj Marrëveshjeje në qoftë se provon që moszbatimi i detyrimeve të tyre është i shkaktuar nga një rast force madhore. Për efekt të kësaj Marrëveshjeje forca madhore siç përkufizuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje përfshin (por pa u kufizuar në to) shkaqet e mëposhtme:

- Defekt në komunikim ose defekt i sistemeve kompjuterike të OST që e pengon Palën Pretenduese të përmbushë detyrimet e lëvrimin ose shpërndarjes;



- Pezullimi nga OST i lëvrimin ose injorimit nga OST të detyrimeve për programet/skedulimin që Pala Pretenduese ka bazuar në kontratë;

- Një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë Palën të përmbushë detyrimet e saj sipas licencës, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të Palës dhe nuk ndodhin për faj të saj dhe Pala nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e saj.

10.2 Secila Palë duhet të marrë të gjitha masat për të shmangur sa më shpejt, arsyen për çdo vonesë ose ndërprerje të zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar dëmet e Palës tjetër. Nëse njëra Palë ka njohuri të forcës madhore, e cila do të ndikojë ose mund të ndikojë në disa ose të gjithë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, ajo duhet që menjëherë të informojë Palën tjetër me shkrim për këtë gjendje. Për të fituar kohë, ky komunikim mund të kryhet edhe me anë të telefonit, por duhet të ndiqet nga një komunikim i menjëhershëm me shkrim. E njëjta gjë zbatohet kur forca madhore ka pushuar/mbaruar.

10.3 Në rastin e forcës madhore, Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të:

i) Vazhdojnë të kryejnë detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, duke dhënë informacion të saktë ditor/orar në lidhje me sasinë e energjisë që mund të shpërndahet, në varësi të rrethanave.

ii) Të tejkalojë rastin/rrethanat e forcës madhore dhe të minimizojë pasojat e forcës madhore.

Neni 11

Ndërprerje të paplanifikuara (avari)

11.1 OSHEE ka të drejtën të ndërpresë sigurimin e shërbimeve të shpërndarjes, kur kërkohet, duke vepruar në përputhje me, si rezultat i ndërprerjeve të paplanifikuara, duke përfshirë raste si:

a) Kur OSHEE është e detyruar të realizojë kufizime në shpërndarjen e energjisë elektrike me qëllim të sigurisë në punë të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas vendimit të bordit të ERE-s “Për miratimin e Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, si dhe vendimit të bordit të ERE-s “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike”, .

b) Sigurimin e furnizimit sipas Standardeve të Shërbimit;

c) Në përputhje me udhëzimet e OST

d) Të mbrojë dhe sigurojë rrjetin në mënyrë që të: mirëmbajë një ambient të sigurt, në përputhje me politikën e shëndetit dhe të sigurisë së OSHEE, të parandalojë mbingarkesat e papritura afatshkurtra të rrjetit, të parandalojë ngritjen ose uljen jashtë kërkesave statutorë të niveleve të tensionit, të mbrojë sigurinë e rrjetit, të shmangë ose të zbutë dëmtimin e pajisjeve për çdo person të lidhur në rrjet.

11.2 OSHEE duhet të provojë se ndërprerja ishte e vetmja mënyrë për të garantuar sigurinë në punë të sistemit të shpërndarjes dhe se furnizimi i KF nuk ishte më i mundur. Në rast se furnizuesi ka pretendime, do të ndiqen procedurat e përcaktuara në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje.

OSHEE në përputhje me kodet e industrisë, rregullat dhe marrëveshjet, do të bëjë përpjekjet më të mira të mundshme në mënyrë që të përfundojë sa më shpejt kryerjen e punimeve dhe minimizojë shqetësimet/problemet për Furnizuesin.

OSHEE do të njoftojë furnizuesin menjëherë pas marrjes dijeni për ngjarjen e ndërprerjes. OSHEE, brenda një dite pune, me anë të një akti teknik do të informojë zyrtarisht Furnizuesin në lidhje me rastin e ndërprerjes.

11.3 Gjatë ndërprerjeve të paplanifikuara të shërbimit, derisa OSHEE të kërkojë të kundërtën, furnizuesi duhet t'i kalojë OSHEE çdo kërkesë që ai merr nga konsumatorët për rikthimin e shërbimeve të shpërndarjes sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 12

Ndërprerje të planifikuara

12.1 Procesi i ndërprerjeve të planifikuara do të bëhet konform Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara nga ERE.



12.2 Në mënyrë që të lejohet furnizuesi të marrë masat e përshtatshme, OSHEE, në përputhje me programin vjetor të remonteve, të rakorduara mes Palëve, do të informojë me shkrim furnizuesin jo më vonë se 20 ditë para fillimit të muajit në të cilin parashikohet kryerja e punimeve të mirëmbajtjes, duke specifikuar zgjatjen e punimeve, objektin (vendin) ku do të kryhen këto punime si dhe konsumatorët që parashikohet t'u ndërpritet furnizimi. Pas këtij njoftimi OSHEE i lind e drejta të fillojë punimet e mirëmbajtjes pa pasur nevojën për një aprovim paraprak nga ana e furnizuesit.

Në rast se furnizuesi ka shkaqe të arsyeshme për të kërkuar mosndërprerjen e energjisë elektrike, njofton OSHEE brenda tre ditë pune nga marrja e njoftimit për remontin. OSHEE vlerëson kërkesën e furnizuesit dhe kthen përgjigje mbi pranimin ose jo të kërkesës, ditën e nesërme të punës pas marrjes së saj.

12.3 OSHEE, në raste të paparashikuara, me qëllim ruajtjen e sigurisë së rrjetit, ka të drejtë të reduktojë programin e shpërndarjes për një periudhë të caktuar kohore, duke njoftuar furnizuesin të paktën 5 (pesë) ditë pune në avancë, si dhe duke provuar që ndërprerja ishte e vetmja mënyrë për të mundësuar sigurinë e rrjetit.

12.4 OSHEE detyrohet të përfundojë kryerjen e punimeve brenda afatit të njoftuar.

12.5 Kur OSHEE i kërkon furnizuesit që të informojë konsumatorët, furnizuesi duhet ta bëjë një gjë të tillë me shpenzimet e veta.

Neni 13

Zbatimi i të drejtave të OSHEE ndaj konsumatorëve fundorë

13.1 OSHEE nuk ka të drejtë të zbatojë direkt të drejtat e saj ndaj konsumatorit fundor (ose sipas kontratës në fjalë, ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike” ose ndryshe) pa njoftuar ose u konsultuar me furnizuesin me përjashtim të rasteve të forcës madhore.

13.2 OSHEE mund të veprojë për të ndërprerë pikën e furnizimit të konsumatorit fundor pa njoftuar ose u konsultuar me furnizuesin në rastet kur ndërprerja është urgjente, ose kur OSHEE ndërpret ndonjë linjë të sipërme private të energjisë elektrike si rezultat i ndalimit të zjarrit ose veprimeve të tjera lehtësuese.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ligjet e zbatueshme

14.1 Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

14.2 Në rast të lindjes së mosmarrëveshjes në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do t'i njoftohet përfaqësuesve të autorizuar të çdo Pale për trajtimin e mosmarrëveshjeve, të cilët do të tentojnë me mirëbesim ta zgjidhin atë sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se Përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'u njoftohet Palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për ato. Në qoftë se përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm, ose në qoftë se një Palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë çështja do të zgjidhet nga ERE sipas ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit apo akteve të tjera të miratuara nga ERE “Për miratimin e rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis te licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe te gazit natyror”.

14.3 Kur mosmarrëveshjet e Palëve i referohen interpretimit të Kodit të Rrjetit, Palët do të veprojnë në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjetit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe vendimi i ERE-s është i detyrueshëm për zbatim nga Palët.

14.4 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, në lidhje me të ose, që rrjedhin nga ajo, në rast se nuk janë zgjidhur në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet 14.2 dhe 14.3 të kësaj Marrëveshjeje, do t'i referohen Qendrës Shqiptare të Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit për zgjidhje me arbitrazh, sipas rregullave dhe procedurave të kësaj Qendre. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga një arbitër i vetëm i zgjedhur në marrëveshje mes Palëve ose, në rast se Palët nuk bien dakord, Qendra do të caktojë një arbitër të vetëm nga lista e saj.



Palët bien dakord që arbitri do të zgjidhë mosmarrëveshjet brenda afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor nga dita e pranimit të detyrës.

Gjuha shqipe do të jetë gjuha e zhvillimit të procedurës për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve.

14.5 Vetëm për mosmarrëveshjet objekti i të cilave tejkalon vlerën e 1 000 000 lekë (një milion), Palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Neni 15

Kundërvajtjet administrative

15 Në rast se një nga palët shkel një prej kushteve të kësaj kontrate, apo çdo legjislacioni në fuqi, pala konstatuese/e dëmtuar ka të drejtë të dërgojë një kërkesë të argumentuar për marrjen e masave nga ana e ERE, sipas nenit 107 dhe/apo nenit 42 të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 16

Autorizimet

16. Palët pohojnë dhe garantojnë se kanë marrë të gjitha autorizimet e nevojshme dhe licencat e kërkuara për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Njoftimet, përfaqësuesit e autorizuar, etj.

17.1 Menjëherë pas firmosjes së kësaj Marrëveshjeje, çdo Palë do të përcaktojë me shkrim një Përfaqësues të autorizuar (Përfaqësuesi i autorizuar) që do të jetë i autorizuar të ndjekë ecurinë e kësaj marrëveshjeje.

17.2 Njoftimet, faturat, (që parashikohen në këtë Marrëveshje) ose dokumente të tjerë në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohen me *faks* dhe/ose *email* në të dhënat e përcaktuara më poshtë dhe do të konsiderohen të marra kur konfirmohet transmetimi. Çdo Palë mund të ndryshojë numrin e saj të faksit dhe/ose adresën e *email*-it duke njoftuar me shkrim Palën tjetër. Në rast se njëra Palë ka ndryshuar numrin e faksit dhe/ose adresën e *email*-it pa njoftuar me parë Palën tjetër, çdo njoftim i dërguar nga Pala tek të dhënat e mëparshme, do të konsiderohet i marrë prej Palës që ka bërë ndryshimin dhe nuk ka njoftuar.

17.3 Palët bien dakord që t'i njoftojnë strukturat e tyre përkatëse për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje dhe t'i udhëzojnë ato për detyrimet që rrjedhin prej saj me qëllim marrjen e të gjitha masave për zbatimin e saj.

17.4 Për çdo ndryshim në përcaktimet e bëra në këtë nen, Palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën brenda 5 ditësh kalendarike.

Personat e autorizuar për të dy Palët do të jenë:

Për OSHEE:	Z/Znj. _____ Pozicioni: OSHEE sh.a. Rruga “Andon Zako Çajupi” (Pallati “Conad”) Tirana tel: +355 4 _____ fax: + 355 4 _____ e-mail: _____
Për Furnizuesin:	Z/znj. _____ Pozicioni: _____ Person i autorizuar i _____ (F) Rruga: _____ tel: + _____ fax: + _____ email: _____



17.5 Secila Palë në këtë Marrëveshje përfaqëson dhe garanton që:

- a) ajo është e përfshirë ose e krijuar dhe ekziston ligjërisht;
- b) ajo ka fuqi të plotë, autorizim dhe të drejtën ligjore për të ekzekutuar, shpërndarë dhe për të kryer detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshje; dhe
- c) që ekzekutimi dhe kryerja e detyrimeve të asaj Pale sipas kësaj Marrëveshje nuk do të çojë në shkelje të detyrimeve kontraktuale ose të detyrimeve të tjera në zotërim të asaj Pale ose të një Pale të tretë.

Neni 18

Afati i zbatimit të Marrëveshjes

18.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi që nga data e fillimit të zbatimit të kontratës të lidhur midis furnizuesit dhe çdo KF, referuar pikës 3 “Kohëzgjatja e kontratës” në aneksin 2.

18.2 Furnizuesi duhet të njoftojë 5 ditë përpara OSHEE për përfundimin e kontratës me secilin prej KF dhe për ndërprerjen e shërbimit të shpërndarjes me qëllim furnizimin me energji elektrike të KF përkatës. Furnizuesi duhet të njoftojë OSHEE-në se ka lidhur kontratë të furnizimit me një klient të ri fundor, një ditë përpara datës së furnizimit.

18.3 Kjo Marrëveshje është e vlefshme dhe i shtrin efektet mes Palëve edhe në rast se, gjatë kohës së zbatimit të saj, furnizuesi njofton se ka ndërprerë kontratën e furnizimit me njërin prej KF ose ka lidhur kontratë të furnizimit me një klient të ri fundor. Furnizuesi do të njoftojë 5 ditë përpara OSHEE dhe palët do të reflektojnë ndryshimet përkatëse në anekset e kësaj Marrëveshjeje. Këto ndryshime nuk do të prekin asnjë prej kushteve të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk do t'i nënshtrohen miratimit të ERE të parashikuar në nenin 20.

Neni 19

Ndryshimet dhe amendimet

19.1 Palët pranojnë që ligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, të cilit i nënshtrohet kjo Marrëveshje për ndryshimet në vazhdim dhe që këto ndryshime mund që nga ana e tyre të kërkojnë që amendimet të bëhen në këtë Marrëveshje. Palët bien dakord që të negociojnë në mirëbesim për çdo ndryshim në këtë Marrëveshje të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme si pasojë e ndonjë ndryshimi tek ligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, ose duke marrë parasysh eksperiencën tregtare.

19.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate miratohet me vendim të bordit të ERE.

19.3 Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohet si një ndryshim automatikisht në këtë kontratë.

Neni 20

Ekzekutimi nga palet

20.1 Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t'u dërguar për miratim në ERE.

20.2 Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.

Neni 21

Shtojcat

Shtesat dhe anekset janë pjesë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22

Dispozita përfundimtare

22.1 Palët shprehimisht marrin përsipër dhe premtojnë që:

- a) të ndërmarrin veprime të cilat janë të arsyeshme, me ndershmëri, qëndrueshmëri dhe është e rëndësishme të mbajnë vazhdimësinë e shërbimit dhe këtë Marrëveshje në ekzistencë;



b) të ndërmjetësojnë dhe ndryshojnë këtë Marrëveshje nëse do të jetë e nevojshme si rrjedhojë e ndryshimeve në ligj ose rregulloreve.

Tiranë, ___ / ___ / ____

Në emër dhe për llogari të OSHEE sh.a. _____	Në emër dhe për llogari të _____ (F) _____ Administrator i _____ (F)
Administrator i OSHEE sh.a.	

ANEKS 1

- Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. ___ datë ___.__.____ “Për dhënien e licencës si furnizues shoqërisë _____”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014 “Për licencimin e shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike sh.a.”, në aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike.

ANEKS 2

Formular njoftimi i kontratave të lidhura midis furnizuesit dhe KF

- Identifikimi i palëve të kontraktuara: _____ (F) dhe KF
- Pikat e livrimit/tërheqjes:
- Kohëzgjatja e kontratës: (fillimi i kon. ___)
- Sasitë e kontraktuara:

Pikat e Matjes (ish aneksi 5)

Emri i KF	N/stacioni dhe/ose Fidrit	Kodi i pikës së matjes në sistemin e OSHEE

ANEKS 2.1

Formular njoftimi i kontratave të zgjidhura midis furnizuesit dhe KF Unilateral dypalëshe

- Identifikimi i palëve të kontraktuara: _____ (F) dhe KF
- Pikat e livrimit/tërheqjes:
- Kohëzgjatja e kontratës: (fillimi i kon. ___)
- Sasitë e kontraktuara:

ANEKS 3

Kushtet për shpërndarjen e energjisë

OSHEE dhe _____ (F) do të zbatojnë Rregullat e Tregut, Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Matjes, Rregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike, si dhe detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje.

OSHEE do të shpërndajë energjinë elektrike, sipas programeve të nominuara, në parametrat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe cilësisë së parametrave të kësaj energjie në pikat e marrjes së energjisë sipas specifikimeve dhe parametrave të dhëna në Kodin e Shpërndarjes.

OSHEE do të aplikojë në faturën e detyrimeve të _____ (F) për energjinë e shpërndarë pagesat apo tarifën e miratuara nga ERE, të cilat miratohen dhe hyjnë në zbatim përgjatë kohës së zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

_____ (F) merr përsipër detyrimin për zbatimin e udhëzimeve dhe kërkesave të dhëna nga OST, që kanë të bëjnë me dispecerimin e Sistemit Elektroenergjetik.



_____ (F) merr përsipër të njoftojë jo më vonë se 10 ditë më parë OSHEE-në për ndryshime të skemës që kanë për pasojë ndryshime të konsiderueshme të kërkesës në një pikë/disa pika marrje të sistemit të shpërndarjes.

ANEKS 4

Matja, rakordimet, etj.

Matja e energjisë elektrike e shpërndarë në sistemin e shpërndarjes nga OSHEE, për llogari të _____ (F), do të bëhet në pikën/pikat e përcaktuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Instalimi, administrimi, rinovimi, kontrolli dhe verifikimi i pajisjeve të matjes janë të rregulluara konform përcaktimeve të Kodit të Shpërndarjes dhe akteve të tjera ligjore/rregulloreve në fuqi.

Për KF të pajisur me sisteme inteligjente matjeje, matja e energjisë elektrike do të bëhet nga OST/OT, për çdo orë të ditës, nga ora 00.00 deri 24.00, me pajisjet, standardet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Matjes. Matjet/konsumi do t'i dërgohen F_____ çdo ditë për çdo KF me të cilin ai ka lidhur kontratë.

Për KF të pajisur me sisteme konveccionale matjeje, matja e energjisë elektrike do të bëhet nga OSHEE në ditën e fundit të muajit të furnizimit, me pajisjet, standardet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Matjes. Faturimi i detyrimeve reciproke, ndërmjet Palëve në Marrëveshje, do të bëhet në fatura mujore mbi bazë të matjeve orare për KF të pajisur me sisteme inteligjente matjeje si dhe me bazë mujore për KF të pajisur me sisteme konveccionale matjeje.

OST/OSHEE do të ofrojë çdo informacion shtesë nga sistemi i matjes në përputhje me kërkesën e _____ (F). Rakordimi i të dhënave të matjes midis Palëve është një detyrim që paraprin procesin dhe afatet e faturimit të detyrimeve mujore ndërmjet Palëve dhe do të bëhet në afatet dhe në përputhje me Rregullat e Tregut.

Meqenëse sistemi i telematjes, për shkak të teknologjisë, mund të ballafaqohet me dështime të transmetimit së të dhënave nga matësi në serverin e qendrës së matjes, por jo dështime të regjistrimit të të dhënave në memorien e vetë matësit, dështime këto që janë mjaft të rralla dhe të shkurtra në kohë, dhe që njoftohen, sinjalizohen automatikisht nga vetë sistemi i matjes, atëherë të dhënat orare/ditore që do të komunikohen nga operatori i matjes/tregut, kur shoqërohen me shënimin e prezencës së dështimeve të pjesshme në pikën e matjes përkatëse, duhet të konsiderohen si të dhëna operative (jo përfundimtare, të vlefshme për faturim) që i shërbejnë çdo pjesëmarrësi të tregut për të vlerësuar pozicionin e tij, në lidhje me konsumin e energjisë elektrike. Të dhënat (matjet) e pa-transmetuara të ruajtura në memorien e matësit përkatës, do të tërhiqen me ndërhyrje manuale dhe do të transmetohen në serverin përkatës në qendër duke ruajtur identitetin e tyre, (orën përkatëse), duke bërë të mundur azhurnimin e tabelës orare të matjeve. Këto të dhëna me bazë orare (të azhurnuara në rastet e shfaqjes së dështimeve) do të shërbejnë si bazë për llogaritjen e bilancit energjetik, faturimit etj.



VENDIM

Nr. 25, datë 15.2.2017

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.169 DATË 31.10.2016 “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE-S NR. 103 DATË 23.6.2016 “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, pika “P”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 19 germa “P”, ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 4118 prot., datë 1.2.2017, në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, konstaton vështirësi në implementimin në afat të rregullave të përcaktuara në Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e

humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sa përket ndërtimit të platformës IT.

- ERE ka nisur më herët procedurat për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103 datë 23.6.2016, dhe është ende në fazën e shqyrtimit të tyre.

Për gjithë sa më sipër,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr.103, datë 23.6.2016, Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, si më poshtë:

- “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, hyn në fuqi brenda datës 30.4.2017”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 26, datë 15.2.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
KONTRATËS PËR OFRIMIN E
SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË
PËRPUTHSHMËRISË**

Në mbështetje të neneve 16, pika 7, dhe 47 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e draftit të kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 27, datë 15.2.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË
RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 16 pika 7, dhe 47 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi

relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore” (RCP),

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore” (RCP).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 28 datë 15.2.2017

**MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË KOMP ENERGIJË SHPK,
ME NUMËR. 248, SERIA PV14K,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE NR.94, DATË
6.10.2014, PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET
“HURDHAS 1”, “HURDHAS 2” DHE
“HURDHAS 3”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, të bordit të ERE; nenit 8, të Kontratës Koncesionare, nr. 2807 Rep, dhe nr. 371 Kol, datë 1.9.2009; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë



së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë Komp Energji sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria Komp Energji sh.p.k ka kryer pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin “A” të kësaj rregulloreje, si dhe pagesën e rregullimit për vitin 2015 dhe rezulton i çliruar nga çdo lloj detyrimi financiar ndaj ERE.

- Shoqëria “Hidropowerplant Construction sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 9 (Formati dhe dokumentacioni për aplikim) të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Hurdhas 1, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3 me numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.94, datë 06.10.2014, duke e zëvendësuar emrin e shoqërisë së licencuar “Komp Energji” sh.p.k, me shoqërinë Hidropowerplant Construction sh.p.k.

2. Të njoftohet shoqëria “Komp Energji” sh.p.k., që të depozitohet në ERE, Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, licencën e prodhimit numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 94, datë 6.10.2014.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 29 datë 15.2.2017

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SH.P.K., ME NUMËR 253, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE NR.102, DATË 7.11.2014, PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, të bordit të ERE; nenit 8, të Kontratës Koncesionare, nr. 2807 Rep, dhe nr. 371 Kol, datë 1.9.2009; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë Komp Energji sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k. ka kryer pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin “A” të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si dhe pagesën e rregullimit për vitin 2015 dhe rezulton i çliruar nga çdo lloj detyrimi financiar ndaj ERE-s.

- Shoqëria “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 9 (Formati dhe dokumentacioni për aplikim) të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e tregtimit të energjisë elektrike, me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 102, datë 7.11.2014, duke zëvendësuar emrin e shoqërisë së licencuar “Komp Energji” sh.p.k., me shoqërinë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

2. Të njoftohet shoqëria “Komp Energji” sh.p.k., që të depozitohet në ERE, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, licencën e tregtimit, me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr.102, datë 7.11.2014.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 31, datë 20.2.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE AKSIONET E
SË CILËS ZOTËROHEN PLOTËSISHT
OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE
TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E
SHËRBIMIT PUBLIK KESH SHA PËR
PERIU DHËN 1 PRILL 2017 – 31
DHJETOR 2017**

Në mbështetje të nenit 16, 19, dhe 47 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neni 10 të VKM-së 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nenin 19 pika 1 germa “c” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e

ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 20.2.2017, mbasi shqyrtoi relacionin “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a., për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017, të përgatitur nga drejtoritë teknike, konstatoi se:

- ERE, në përmbushje të përgjegjësive që i ngarkon ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, në mënyrë të veçantë referuar nenit 19, germa “c” paragrafi “iii”, miraton, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar, tarifatat për veprimtaritë e licencuara për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik.

- KESH sh.a., me shkresën nr. 162. Prot. datë 11.1.2017, ka kërkuar rishikimin e tarifës, që të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen me BERZH pas miratimit të ligjit nr. 125/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë së huas me BERZH për “Planin e ristrukturimit të KESH””.

- KESH sh.a. ende nuk ka paraqitur pranë ERE-s një aplikim të saj për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 prill 2017-31 dhjetor 2017 në të cilin të parashtrijë me shifra, argumente dhe analizë ekonomike nevojën për të ardhura të mjaftueshme për veprimtarinë normale dhe arritjen e pikësnyimeve të saj.

- Me qëllim që të përcaktojë sa më drejt çmimet e shitjes së energjisë elektrike tek klientët fundorë, ERE duhet t’u referohet kostove reale për të gjithë aktivitetet e rregulluara, përfshirë këtu edhe atë të prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria OSHEE sh.a., në aplikimin e saj për tarifë për vitin 2017, nuk ka kërkuar ndryshim të çmimeve për klientët fundorë, por rialokim të kostove për nivele tensioni.

- Në shkresën nr.682 Prot., datë 31.1.2017 MEI shprehet se “Për të përmbyllur me sukses këtë proces, vlerësojmë se është e nevojshme kryerja nga ana e ERE-s e një analize të drejtë të të ardhurave të kërkuara dhe kostove reale të operimit për secilën prej shoqërive publike, KESH, OST dhe OSHEE, me qëllim miratimin



e tarifave përkatëse për vitin 2017 të cilat duhet të jenë transparente dhe të sigurojnë zhvillimin normal të aktivitetit në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat për qëndrueshmërinë e sistemit dhe stabilitetin financiar të sektorit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 32, datë 20.2.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË
SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR KLIENTËT
FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA
FURNIZUESI I SHËRBIMIT
UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1 PRILL
2017 – 31 DHJETOR 2017**

Në mbështetje të nenit 16, 19, 47 dhe 83 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 6 pika 2 dhe 10 të VKM-së nr. 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nenit 19 germa “c” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e

datës 20.2.2017, mbasi shqyrtoi relacionin “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimet nr.191 datë 22.12.2016 dhe nr. 192 datë 22.12.2016, ka filluar procedurat për shqyrtimin e aplikimeve për tarifa të reja të shërbimit të transmetimit dhe ato të shpërndarjes për çdo nivel tensioni për vitin 2017, bazuar në aplikimet e shoqërive OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., respektivisht me shkresat nr.7260/1 datë 30.11.2016 dhe nr.29445 Prot., datë 9.12.2016.

- Shoqëria OSHEE sh.a., në aplikimin e saj për tarifë për vitin 2017, ka kërkuar mosndryshim të çmimeve për klientët fundorë por rialokim të kostove për nivele tensioni.

- OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE disa vlerësime/llogaritje lidhur me të ardhurat e kërkuara për aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë për vitin 2017 si argumente për mosndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë të klientët tariforë.

- Në shkresën nr.682 Prot., datë 31.1.2017, MEI shprehet se “Për të përmbyllur me sukses procesin e reformimit të sektorit elektroenergetik është e nevojshme kryerja nga ana e ERE-s e një analize të drejtë të të ardhurave të kërkuara dhe kostove reale të operimit për secilën prej shoqërive publike, KESH, OST dhe OSHEE, me qëllim miratimin e tarifave përkatëse për vitin 2017 të cilat duhet të jenë transparente dhe të sigurojnë zhvillimin normal të aktivitetit në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat për qëndrueshmërinë e sistemit dhe stabilitetin financiar të sektorit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 3, datë 3.2.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS
KANALIZIME PATOS

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Patos, me:

- Drejtues ligjor: Petrit Elmazaj;
- Drejtues teknik: Artur Baxhia.

2. Operatori sh.a Ujësjiellës Kanalizime Patos autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Patos, Bashkia Fier, Njësia administrative Portëz, Cakran.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 4, datë 3.2.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 26, DATË 20.5.2016 “PËR LICENCIM
SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME
ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 26, datë 20.5.2016 “Për licencim sh.a. Ujësjiellës - Kanalizime Elbasan” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:
- Drejtues ligjor: Mikel Gjokthomi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 5, datë 3.2.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS
KANALIZIME POGRADEC

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Pogradeç, me:

- Drejtues ligjor: Marsel Isallari
- Drejtues teknik: Albert Tavaxhiu
- Drejtues teknik: Ilir Vako

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Pogradeç autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:



Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

Kategoria D, për përpunimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Pogradec.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 6, datë 3.2.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a Ujësullës Kanalizime Gjirokastrë, me:

- Drejtues Ligjor: Bashkim Tola
- Drejtues Teknik: Besnik Kocaqi

2. Operatori sh.a Ujësullës Kanalizime Gjirokastrë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Gjirokastrë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 7, datë 3.2.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS POLIÇAN

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësullës Poliçan, me:

- Drejtues ligjor: Klajdi Brahim
- Drejtues teknik: Klajdi Brahim

2. Operatori sh.a Ujësullës Poliçan autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Poliçan, Bashkia Skrapar, njësi administrative Bogovë (pjes.), Vëndreshë (pjes.)

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

KËRKESË

Shtetasi Muhamet Murati, i biri i Demiralit dhe i Xhemiles, i datëlindjes 23.2.1954, lindur dhe banues në Vlorë kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të vdekur të shtetases Rita Murati.

KËRKUES
Muhamet Murati

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë